



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/150

Datë: 23.12.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkriptit nga mbledhja e 148 e Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/150

Datë: 23.12.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 3 të Ligjit Nr. 03/L-218 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2010, mori

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për reduktimin e ndarjeve buxhetore në shumë prej €5,000,000 për komunat serbe (zbatimi i Vendimit të Qeverisë Nr.01/142, datë 26.08.2010).

1.1. Për të realizuar pikën 1 të këtij Vendimi mjetet merren nga:

1.1.1. €5,000,000 Ministria e Punëve të Jashtme, programi - Ambasadat, kategoria ekonomike: Shpenzime Kapitale,

1.2. Pjesa e mjeteve në shumë prej €3,277,591.02, ndahet nga pika 1.1. e këtij Vendimi në bazë të realizimit të dinamikës së tanishme të projekteve dhe transferohet në komunat si vijon:

1. €2,000,000, Graçanicë, programin-Administrata dhe personeli, Kapitale
2. €93,999.21, Novobërdë, programi - Buxhet dhe financa, Kapitale
3. €226,849.31, Ranillug, programin - Zyra e Kryetarit, Kapitale
4. €532,493.94, Shtërpca, programi- Zyra e Kryetarit, Kapitale
5. €237,835.41, Kllokot, programi - Buxhet dhe financa, Kapitale
6. €186,413.15, Partesh, programin - Zyra e Kryetarit, Kapitale

1.3. Pjesa e mjeteve të mbetura (të patransferuara) në shumë prej €1,722,408.98 do të transferohet në komunat nga pika 1.2. e këtij Vendimi sipas dinamikës së realizimit të projekteve kapitale.

2. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për reduktimin e ndarjeve buxhetore në shumë prej €4,843,826 nga:

- 2.1. €1,032,964, Ministria e Punëve të Jashtme, programi Ambasadat, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale,
 - 2.2. €267,036, Ministria e Punëve të Jashtme, programi Administrata qendrore kategoria ekonomike: shpenzime kapitale.
 - 2.3. €245,128, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, programi Administrata Qendrore, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale,
 - 2.4. €82,875, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, programi- Agjensioni për Regjistrimi të bizneseve, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale,
 - 2.5. €8,427, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, programi Departamenti i Metrologjisë, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale,
 - 2.6. €502,049, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës, programi – Forca e Sigurisë së Kosovës, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale,
 - 2.7. €140,000, Ministria për Ekonomi dhe Financa, programi –Doganat, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale.
 - 2.8. €1,944,664, Ministria për Ekonomi dhe Financa, programi –Energjia-KEK, kategoria ekonomike: Subvencione dhe transfere.
 - 2.9. €550,683, Ministria për Ekonomi dhe Financa, programi –Administrata qendrore, kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime.
 - 2.10. €70,000, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, programi- Agjensioni i Pyjeve të Kosovës, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale
3. Mjetet e kursyera nga pika 2 e këtij vendimi ndahen si vijon:
- 3.1. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €19,688 transferohen në Ministrinë e Administratës Publike, programi i Teknologjisë Informativë, kategoria e Pagave dhe Mëditje,
 - 3.2. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €350,000 transferohen në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, programi - Departamentit i Thesarit, kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime, pagesa e taksave për programit me FMN-në, “Stand By Arrangement”,
 - 3.3. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €1,000,000 transferohen në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, programi - Departamentit i Thesarit, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere, ndihmë popullit të Shqipërisë me rastin e vërshimeve në muajin dhjetor 2010,
 - 3.4. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €1,825,000 (zbatimi i Vendimit të Qeverisë Nr. 07/109, datë 2.02.2010) transferohen në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere, programi – Pensionet e Invalidëve të Luftës,

- 3.5. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €190,810 i transferohet Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së, ndihmë për furnizim me dimërishte, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.
- 3.6. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €776,600 në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere, programi- Shërbimet Sociale.
- 3.7. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €500,000 në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, programi i Thesarit, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere, përmbytjet në Komuna e Kosovës.
- 3.8. Pjesa e mjeteve të kursyera nga pika 2 në shumë prej €120,000 në Komunën e Ferizajt, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale, në Komunën e Drenasit €16,728, kategoria ekonomike: shpenzime kapitale, në Komunën e Novobërdës €45,000, kategoria ekonomike shpenzime kapitale.
4. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për transferin e mjeteve në shumë prej €107,000 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor:
 - 4.1. €100,000, nga kategoria ekonomike: shpenzime kapitale, programi, Departamenti i Mjedisit, projekti „Ndërtimi i objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme“ (kodi i projektit 10204),
 - 4.2. €7,000 nga kategoria ekonomike: shpenzime kapitale, programi, Fshati Hade, projekti “Fshati Hade” (kodi i projektit 08140).
 - 4.3. Mjetet transferohen në programin -Fshati Hade, kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime.
5. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për reduktimin e mjeteve në shumë prej €90,376.32 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe ndahen në Komunat: Skenderaj dhe Malishevë (zbatimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/148 datë 5.11.2010).
 - 5.1. Për të realizuar pikën 5 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në shumën prej €90,376.32, programi - Administrata qendrore, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere dhe transferohen në:
 - 5.1.1. €48,354.12, në Komunën e Malishevës, programi - Arsim dhe Shkencë, kategoria ekonomike: e paga dhe mëditje, dhe
 - 5.1.2. €42,022.20, në Komunën e Skenderajt, programi -Arsim dhe Shkencë, kategoria ekonomike: paga dhe mëditje.
6. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për ndarjen e mjeteve në shumë prej €4,556,376 për Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, projekti Blerja e Librave (teksteve) shkollore nga klasa 1-9.

- 6.1. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në shumën prej €400,000, programi-Administrata qendrore, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere;
- 6.2. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në shumën prej €760,652 edhe atë nga:
 - 6.2.1. €752,674, programi-Shpenzimet kontingjente për Komunat e reja, kategoria e shpenzimeve kapitale.
 - 6.2.2. €7,978, programi-Administrata qendrore, kategoria e shpenzimeve kapitale.
- 6.3. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Punëve të Brendshme, në shumën prej 658,467, nga kategoria e shpenzimeve kapitale, edhe atë sipas programeve:
 - 6.3.1. €19,918, programi Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
 - 6.3.2. €29,760, programi i Hetimeve, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
 - 6.3.3. €192,292, programi Shërbimet e mbështetjes, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
 - 6.3.4. €215,585, programi Policia Kufitare, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
 - 6.3.5. €200,912, programi për Kufi Azil dhe Migracion, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
- 6.4. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Energjisë dhe Minierave, programi Administrata Qendrore, në shumën prej €58,800, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.
- 6.5. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, në shumën prej €5,251, nga kategoria e shpenzimeve kapitale.
- 6.6. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, programi-KOSTT, në shumën prej €283,270, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.7. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, programi-Uji dhe Hedhurinat, në shumën prej €155,760, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.8. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Drejtësisë, programi-Prokuroret Special, në shumën prej €46,813, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.

- 6.9. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Drejtësisë, programi-Shërbimi Korrektues-Burgjet, në shumën prej €4,436, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.10. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Punëve të Jashtme, programi - Administrata Qendrore, në shumën prej €150,000, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.11. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, programi- Sekretariati i KGJK-së, në shumën prej €203,612, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.12. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Kuvendi, në shumën prej €321,097 edhe atë:
- 6.12.1. €35,000, programi-Anëtarët e Kuvendit, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
- 6.12.2. €18,000, programi- Administrata e Kuvendit, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
- 6.12.3. €38,097, programi- Administrata e Kuvendit, kategoria ekonomike e shpenzimeve komunale
- 6.12.4. €230,000, programi Administrata e Kuvendit, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.13. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Zyra e Kryeministrit, në shumën prej €101,256 edhe atë:
- 6.13.1 €22,984, programi - Zyra e Kryeministrit, kategoria ekonomike e shpenzimeve komunale.
- 6.13.2 €78,272, programi - Këshilli i Sigurisë së Kosovës, kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.
- 6.14. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, programi- Departamenti i Prodhimtarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, në shumën prej €65,000, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.15. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Administratës Publike, në shumën prej €582,972 edhe atë:
- 6.15.1. €57,618, programi- Shërbimet e Administratës Civile, kategoria ekonomike e Shpenzimeve Kapitale.
- 6.15.2. €425,999, programi- Departamenti i Inxhinieringut, kategoria ekonomike e shpenzimeve Kapitale.
- 6.15.3. €48,130, programi- Enti i Statistikave, kategoria ekonomike e shpenzimeve Kapitale.

- 6.15.4. €51,225, programi-Teknologjia Informative, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.16. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në shumën prej €243,000 edhe atë:
- 6.16.1. €200,000, programi Departamenti i Mjedisit, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
- 6.16.2. € 43,000, programi Departamenti i Planifikimit Hapësinor, kategoria e ekonomike shpenzime kapitale
- 6.17. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Agjencioni Kosovar i privatizimit në shumën prej €380,000 dhe atë:
- 6.17.1. €75,000, programi Administrata qendrore, kategoria mallra dhe shërbime
- 6.17.2. €35,000, programi Administrata qendrore, kategoria: shpenzime komunale
- 6.17.3. € 60,000, programi Administrata qendrore, kategoria shpenzime kapitale
- 6.17.4. €90,000, programi Departamenti ligjor, kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime
- 6.17.5. €20,000, programi i Auditimit, kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime
- 6.17.6. €80,000, programi kontrolli dhe mbikëqyrja, kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime
- 6.17.7. €20,000, programi kontrolli dhe mbikëqyrja, kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere
- 6.18. Për të realizuar pikën 6 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Arsimit, Shkencë dhe Teknologjisë në shumën prej €135,990 dhe atë:
- 6.18.1. €26,800, programi Administrata qendrore, kategoria ekonomike: shpenzime komunale.
- 6.18.2. € 17,690, programi Zyra e ministrit, kategoria ekonomike: mallra dhe shërbime.
- 6.18.3. € 8,000, programi Departamenti Arsimit me Nevoja Speciale, kategoria ekonomike: Shpenzime komunale.
- 6.18.4. €83,500, programi Universiteti i Prizrenit, kategoria ekonomike:shpenzime komunale.

7. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për transferin e mjeteve në shumë prej €790,000, brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme nga programi Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, në programin- Departamenti i Regjistrimit të Automjeteve dhe Patentshofereve, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
8. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për transferin e mjeteve në shumë prej € 24,306, brenda Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga programi Zyra e Ministrit, kategoria ekonomike paga dhe mëditje, në të njëjtën kategori ekonomike në këto programe: Administrata qendrore në shumë prej €11,293; Sportet e gjëra, në shumë prej 1,087; Arritjet sportive në shumë prej €1,915; Përkrahja Institucionale për Kulturë, në shumë prej €7,534 dhe në - Trashëgimi Kulturor € 2,477.
9. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për reduktimin dhe ndarje të mjeteve në shumë prej €3,000,000 për mirëmbajtjen e rrugëve.
 - 9.1. Për të realizuar pikën 9 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Minierave dhe Energjisë, programi Administrata Qendrore, kategoria ekonomike mallra e shërbime në shumën prej €3,000,000, programi- Administrata qendrore, kategoria ekonomike, mallra e shërbime;
 - 9.2 Për të realizuar pikën 9 të këtij Vendimi mjetet ndahen në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, programi "Mirëmbajtja e rrugëve", kategoria ekonomike, mallra e shërbime, në shumën prej €3,000,000.
10. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për reduktimin dhe ndarje të mjeteve në shumë prej €1,746,491 për Ministrinë e Punëve të Brendshme, kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Për të realizuar pikën 10 të këtij Vendimi mjetet merren nga:

 - 10.1. €583,000, programi Shërbimet e mbështetjes, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, MPB-Policia e Kosovës.
 - 10.2. €141,200 programi- Administrata qendrore, kategoria ekonomike, mallra e shërbime, nga Ministria e Minierave dhe Energjisë,
 - 10.3. € 488,203, programi Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve, kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale.
 - 10.4. € 36,032, programi për Kufi Azil dhe Refugjat, kategoria ekonomike, mallra e shërbime;
 - 10.5. €106,000, programi i Shërbimeve Mbështetëse, kategoria ekonomike, shpenzimeve komunale;
 - 10.6. €110,930, programi i Shërbimeve Mbështetëse, kategoria ekonomike, mallra e shërbime;

10.7. €200,000, programi për të Riatdhësuarit, kategoria ekonomike, mallra e shërbime;

10.8. €63,056, programi për Kufi Azil dhe Refugjat, kategoria ekonomike, mallra e shërbime;

10.9. €18,070, programi Policia kufitare, kategoria ekonomike, mallra e shërbime.

Për të realizuar pikën 10 të këtij Vendimi mjetet ndahen për:

10.10. €1,483,435, në programin -Policia e Kosovës, nënprogrami Shërbimet Administrative,

kategoria ekonomike, Paga dhe mëditje;

10.11. €263,056, programi administrata qendrore, kategoria ekonomike, Paga dhe mëditje;

11. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave për reduktim dhe ndarje të mjeteve në shumë prej €1,000,000.

11.1. Për të realizuar pikën 11 të këtij Vendimi mjetet merren nga Ministria e Shëndetësisë, në shumën prej €1,000,000, si vijon:

112.1.1 € 699,318, programi Qendra Klinike Universitare e Kosovës, kategoria ekonomike shpenzime kapitale,

11.1.2. € 182,389, programi Spitali Rajonal, Gjakovë, kategoria ekonomike shpenzime kapitale,

11.1.3. € 10,230, programi Spitali Rajonal, Vushtrri, kategoria ekonomike shpenzime kapitale,

11.1.4. € 57,822, programi Kujdesi primar shëndetësor, kategoria ekonomike shpenzime kapitale,

11.1.5. € 46,500, Agjensioni i Kosovës për Produkte Medicinale, kategoria ekonomike shpenzime kapitale,

11.1.6. € 3,740, programi Programet tjera, kategoria ekonomike shpenzime kapitale,

11.2. Për të realizuar pikën 11 të këtij Vendimi mjetet ndahen në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në shumë prej €1,000,000, programi, Departamenti i Planifikimit Hapësinor, kategoria ekonomike, shpenzime kapitale për projektin - Memoriali "Adem Jashari"- Prekaz.

12. Autorizohet Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që në bazë të Ligjit Nr. 03/L-218 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-177 për Buxhetin e

Republikës së Kosovës për vitin 2010, neni 3 të transferoj mjetet e lira të ndarjeve buxhetore tek Organizatat të tjera buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për të mbuluar minusin në kategorinë e pagave dhe mëditjeve (pagat e rregullta, kompensime dhe shujta), deri në masën e mjeteve të pashpenzuara.

13. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe të gjitha Organizatat buxhetore të ndikuara me këtë Vendim.
15. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/150

Datë: 23.12.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me paragrafin 2 të nenit 72 të Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore, Shkencore, si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2010, mori

V E N D I M

1. Veprimtaria Kërkimore-Shkencore në Republikën e Kosovës, të avancohet me hulumtime të vazhdueshme të fushave të ndryshme shkencore, të jetë në linjë me arsimin e lartë, ndërmarrjet dhe biznesin dhe të prijë në zhvillimin ekonomiko-shoqëror në Republikën e Kosovës.
2. Këshilli Kombëtar i Shkencës zhvillon procedurën e vlerësimit të gjendjes në institutet shkencore ekzistuese deri më 31.12.2011.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 06/150

Datë: 23.12.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2010, mori

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Reagimit Kombëtar.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/150


Datë: 23.12.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2010, mori

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi i pronave të paluajtshme private në ngastrat kadastrale të paraqitura në tabelat të cilat janë pjesë e këtij vendimi për ndërtimin e autostradës Vërmicë- Merdare në segmentin e katërt (4) të zonave kadastrave Suharekë, Sllapuzhan, Bllacë dhe një pjesë e zonës kadastrale e Duhlës, nga kilometri i 34 deri të kilometri 43 si dhe ngastra me Nr.1442 një shtëpi Vërmicë.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Ministria për Ekonomi dhe Financa, dhe Kuvendi Komunal i Suharekës, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Ministria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë e këtij vendimi është akti i vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilat janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit Ministria për Ekonomi dhe Financa të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar me këtë vendim.

6. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronarë ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejt dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura këtij vendimi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe Kuvendi Komunal i Suharekës.
8. Vendimi përfundimtar hynë ne fuqi ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Kuvendit Komunal të Suharekës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/150


Datë: 23.12.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 10 dhe 45 të Ligjit Nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme si dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 dhjetor 2010, mori

V E N D I M - P R E L E M I N A R

1. Miratohet ndryshimet dhe plotësimet për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve, pretenduesve dhe zotëruesve të interesit në pronat e paluajtshme, që ndodhen brenda segmentit 1, 2 dhe 3.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa, Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit dhe Kuvendi Komunal i Suharekës dhe Prizrenit.
3. Obligohet Ministria për Ekonomi dhe Financa që në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Suharekës dhe Prizrenit ti dërgojë vendimin preliminar subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuarën tabelat e bashkangjiturat këtij vendimi, brenda 5 ditëve te punës pas nxjerrjes së vendimit.
4. Ministria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit do të bëjë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi.
5. Kundër këtij vendimi apo cilëso pjesë të tij ka të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në bazë të legjislacionit në fuqi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar, pretendues ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme.

6. Vendimi hynë ne fuqi ne datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Kuvendit Komunal të Suharekës
- Arkivit të Qeverisë